URDHËR
Nr. 524, datë 23.9.2019

PËR AUTORIZIMIN E *"TENUIS LABORATORIES"* PËR KRYERJEN E ANALIZAVE LABORATORIKE TË MOSTRAVE TË MARRA GJATË KONTROLLIT ZYRTAR DHE TIPIN E ANALIZAVE QË ËSHTË I AUTORIZUAR TË KRYEJË

(ndryshuar me urdhrin nr. 21, datë 26.1.2022)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe nenit 59, pikat 1 dhe 9, shkronja "a", të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e *"Tenuis Laboratories"*, me NIPT: L81904506I, si laborator të autorizuar për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të marra gjatë kontrollit zyrtar, për llojin e analizave, sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij urdhri, deri më datë 25.11.2022.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

SHTOJCA I

PRODUKTI	LLOJI I ANALIZËS	TEKNIKA E PROVËS
Vajra	Përcaktimi i aciditetit	Titullim
	Numri i peroksideve	
	Delta K	Spektrofotometer
Ushqime: fruta të thata	Numërim i maja dhe myqe	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë brumi dhe nënprodukte të saj	Numërim i maja dhe myqe	Numërim në pjatë
Ushqim gati për konsum human	Numërim i kolonive bakteriale në 30^0C	Numërim në pjatë
Ushqime: fruta dhe perime të freskëta	Numërim i Escherichia Coli, beta-glukoronidasi pozitive	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë mish dhe nënproduktet e saj	Numërim i Escherichia Coli, beta-glukoronidasi positive	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë veze dhe nënprodukte të saj	Kërkimi i Salmonella spp	Kërkim në pjatë
Ushqime të përpunuara gati për konsum human	Kërkimi i Listeria monocytogenes	Kërkim në pjatë